

Financuar nga:



NJOFTIM PËR EKSPERT I MEDIAS SOCIALE

Kontraktues:	CBS Creative Business Solution
Tipi i kontratës:	Kontratë Shërbimi
Kohëzgjatja:	8 ditë pune (<i>e shtrirë në 1.5 muaj</i>)
Referenca e linjës buxhetit:	6.4
Data e publikimit:	13.06.2018
Afati i aplikimit:	19.06.2018

Informacion i përgjithshëm

Creative Business Solutions po zbaton projektin “*Monitorimi i Performancës së Bashkisë Dibër & Ndërgjegjësimi Komunitar për Pjesëmarrje*” i cili mbështetet në kuadër të projektit PACT të financuar nga Bashkimi Evropian, Delegacioni në Shqipëri dhe zbatuar nga ANTTARC në partneritet me ALCDF dhe AfS. Objektiv i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në promovimin e qeverisjes së mirë, transparencën e shpenzimeve publike dhe pjesëmarrjen aktive të publikut në praktikën e ndershme dhe shpenzimet efikase publike në nivel lokal në Shqipëri. Projekti i cili është në fazë zbatimi, si pjesë të ndërhyrjes së tij parashikon “3 (tre) fushata të avancuara të Medias Sociale” të cilat do të konceptohen dhe zbatohen nga një ekspert i fushës. Fushatat do të synojnë rritjen e ndërgjegjësimit publik, informim në të kuptuarit e shpenzimeve locale dhe nxitjen e një diskutimi të hapur publik.

Qëllimi i Njoftimit dhe Përshkrimi i punës

Kjo kërkesë i drejtohet ekspertëve që mund të ofrojnë shërbime të kualifikuara të medias sociale. Eksperti i përzgjedhur do të jetë përgjegjës për konceptimin dhe zbatimin e 3 (tre) fushatave të avancuara në median sociale të cilat do të mbështeten në një strategji të hartuar paraprakisht për përdorimin e Medias Sociale për qëllimin e vendosur. Fushata do të furnizohet me të dhëna të gjeneruara dhe përpunuara nga zhvillimi i një sondazhi të kryer paraprakisht në qytetin e Peshkopisë. Ato do të kenë në fokus publikimin e rezultateve të sondazhit përdorur elementë të ndryshëm dixhitalë siç janë: infografikët, video të shkurtra ku do të pasqyohen grafikë, rezultate në formë grafike etj. duke nxitur debatin dhe rritur ndërgjegjësimin publik mbi shpenzimet lokale. Eksperti gjithashtu do të mbulojë edhe komunikimin e arritjeve të projektit në kanalet e Medias Sociale.

Financuar nga:



Kriteret e vlerësimit

Të gjitha aplikimet do të vlerësohen në mënyrë të barabartë dhe në fshehtësi të plotë. Kriteret e përzgjedhjes janë si më poshtë:

	%
Kërkesa Teknike	80
Eksperienca e mëparshme	20
Përvojë në hartimin strategjik të fushatave në mediat sociale dixhitale	25
Aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe kreativiteti	20
Kapaciteti për dorëzimin e punës në kohë	15
Intervista	20
Totali	100

Mënyra e pagesës

100% pas zbatimit të suksesshëm të detyrave të paracaktuara dhe me dorëzimin e raportit final;

Aplikimi

Kandidatët e kualifikuar dhe të interesuar duhet të dorëzojnë në e-mail info@cbs.al një CV të shoqëruar me një letër të shkurtër motivimi jo më vonë se data 19/06/2018, duke përfshirë "Ekspert i Medias Sociale" në subjekt të e-mail. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen. Megjithatë, të gjithë aplikuesit do të marrin një përgjigje.

Rreth CBS

Creative Business Solution, është një organizatë konsulence biznesi, jo fitim-prurëse me ekspertizë të theksuar në fushën e konsulencës financiare, financimin e sektorëve në zhvillim, asistencës teknike dhe zbatimin e projekteve zhvillimore me impakt të gjerë në zhvillimin ekonomik. Përmes veprimtarisë së saj CBS zbaton projekte komplekse në Shqipëri me ndikim edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor. CBS ofron shërbime të vlefshme dhe efektive duke gjeneruar rritje ekonomike për bizneset, në sektorët e zhvillimit të ekonomisë, bujqësi, energji të pastër, turizëm etj. Ekipi i CBS numëron rreth 35 punonjës, të cilët operojnë në zyrat qendrore në Tiranë si dhe katër degë lokale në Fier, Korçë, Gjirokastrë dhe Peshkopi. CBS është partner zyrtar me USAID dhe ka marrëdhënie institucionale me organizata donatore ndërkombëtare. Gjithashtu, CBS ka bashkëpunim të ngushtë me bankat komerciale më të mëdha në vend dhe institucionet financiare, marrëdhënie aktive me mbi 400 SME dhe bashkëpunim me institucionet qeveritare.

Site zyrtar: www.cbs.al